

Dëshmi Personale - Mrekulli në Kishën e Profetit Ilia, (Shëndëlliut) Nga z. Ferdinand Babasikas



Shpesh kemi degjuar, mesuar per mrekullite e Zotit per te gjithë te dukurave dhe te padukurave.

Dje mesova qe ne mbeturinat e nje shtepie ne rrethinat e Athines mbas djegejes se saj, pikerisht ne vatren e zjarrit nuk ishte djegur vetem ikona e kryehengjellit Shen Mehillit.

Besoj se eshte e kuptueshme. Ndaj cdo here themi Lavdi Zotit. E tij u befte ne jete te jeteve.

Ishte pranvera e vitit 95 apo 96 shoku im i femijerise Kozma Rrapi gjate ngrenies se ushqimit te drekes ne kombinat ndjen nje pirje te kembeve. E cojne menjehere ne spital. Reatomologia e keshillon te shtrohet. Me konsultimet me familjaret Komi shtrohet dhe i nenshtrohet ekzaminimeve mjekesore me disa specialiste por rezultati negative, paraliza i mori edhe krahët dhe disi me vone d gjithë trupin.

Mbas nje muaji ne spitalin e Beratit Komin e mire e cojne kallep ne spitalin nr 5 ne Tirane. Nje muaj e gjysem atje dhe profesori ju thote familjave merreni ne shtepi tani Zoti ne befte gje.

Po, Zoti e beri mbrekulline. Ishte data 19 korrik mbas dite kur me autombulanxe e nisen per ne Berat. Nena e tij znj. Marianthi nje besimtare e devoteshme, kujdestarja vullnetare kishezes se Shen Thanasit vendosi, djalin do ta coje ne kishen e Shendelliut, keshte tha edhe profesor Petrela mermeriti ajo nder buze. Do te gdhihemi atje. Edhe Komi kallep aprovoi me tundje e kokes veshtiresisht.

Ne kishen e profetit Ilia e priti at Vangjeli. Kozmai do te gdhihet ne ajodhime tha prerazi papu. Me vune nje nje karrige dhe me mbuluan me mantelin e priftit thote Komi ndersa familjaret te frikesuar se do ta humbisnin u gdhine ne ambjentet e kishes.

Tere naten si ne gjume, thote Komi, ndjeja si zjarllek, me vinin djerse dhe me beheshe sikur dikush me ferkonte ballin, sikur me perkeledhelte floket, beja te zgjohesha por nuk mundesha. Ne te gdhire e ferkova ballin me duart e mia. Mamaja, ime shoqe u mbrekulluan, te gjithë u habiten kur une u ngrita ne kembe. Mos u habisni thote Marianthi duke lotuar nga gezimi, Zoti eshte ne mes nesh therriti ajo, Lavdi me ty o Zot perseritnin shpesh te gjithë besimtares ne ditën e Shen Ilias.

Zbriem, thote Komi dhe nga deshira doja vetem te ecja i vizitova te gjithë komshinjte. Qendrot, Lekat, Nushet etj. etj. Te gjithë falenderonin Zotin qe Kozma Rrapin e ktheu ne jete ne gjirin e familjes. Po, profeti Ilia ndermjetesoi per mua i dashur Fred qe une sot jam duke pire kafe me shokun tim te klases ne shkollen 7-vjecare.